



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve me Likuidim Nr.51

**Njësia nr.71
Auto Moto Lipjan**

Emri i NSH-së	NSH Auto Moto Prishtina ("Ndërmarrja")
Lloji i shitjes	Shitja me Likuidim me ofertë të mbyllur
Dita e Ofertimit	Me 23 Tetor 2019 nga ora 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
Depozita e Ofertës	30,000 Euro
Vendndodhja e Aseteve	<p>Lipjan, Rr. Hajredin Bajrami, pn.</p> <p>Auto Moto Lipjan përfshinë objektin afarist P+N me material të fortë me sipërfaqe të përgjithshme prej 482 m² nga të cilat; përdhesa që përfshinë sipërfaqen prej 343 m² dhe nënkulmi me sipërfaqe prej 139 m².</p> <p>Poashtu, përfshihen edhe Objektet përcjellëse të karakterit të përkohshëm prej llmarine ndërtuar më herët nga KFOR-i me sipërfaqe totale prej 373 m² të cilat nuk evidentohen në certifikatën pronësore:</p> <p>Objekti 1 me sipërfaqe prej 143 m², Objekti 2 me sipërfaqe prej 91 m² dhe Objekti 3 me sipërfaqe prej 139 m²</p> <p>Këto objekte gjenden në parcelën kadastrale nr. 01189-5, ZK Lipjan me sipërfaqe të përgjithshme prej 5985 m² (59 ari 85 m²) e cila përfshihet poashtu në shitje. prona gjendet në Rrugën "Hajredin Bajrami" p.n. në Lipjan. Sipërfaqja tokësore e përfshirë në këtë shitje është evidentuar në certifikatën/njësinë kadastrale P-71409044-01189-05 dt. 19.08.2019 ZK Lipjan kurse si pronar paraqitet "P.SH. Auto Moto e Kosovës".</p> <p>Shënim i rëndësishëm: objekti kryesor është paraqitur në kopjen e planit kurse, Objektet përcjellëse 1, 2 dhe 3 nuk janë të evidentuar në certifikatën e pronësisë e as në kopjen e planit. Brenda parcelës së lartcekur gjendet edhe një trafo e rrymës. Kjo trafo nuk është pjesë e shitjes.</p> <p>Në Certifikatën pronësore <u>figuron barra tatimore e vendosur</u> nga data 02.02.2012 e cila do të hiqet në koordinim me ATK (marrëveshja e mirëkuptimit)</p>
Shfrytëzuesit	Lokali afarist për momentin shfrytëzohet me qira.
Detyrimet që do të barten	Nuk ka detyrime që do të transferohen tek pronari i ri, megjithatë blerësi duhet të ketë parasysh se tatimi mbi transferimin e pronësisë mund të zbatohet.

Foto/fotot
Ose informata të tjera
Për asetet në shitje



Informatat

Departamenti i Marketingut, Marrëdhënie me Publikun dhe Investitorë
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext.1105, 2055
Fax: +381 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org

Dokumentet e
Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Agim Ramadani nr.23
10000 Prishtinë, Kosovë

Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marrë parasysh natyrën e tyre. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dosjen elektronike dhe dokumentet për ofertim. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në apo artikujt e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Këto të dhëna janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme të cekura në Rregullat e Tenderit të cilat mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: www.pak-ks.org